

VENDIM
“Per vendosjen e sekuestros ”

Gjykata e Rrethit Gjyqesor Tirane e perbere prej:

GJYQTARE – BRUNILDA KADI

Asistuar nga sekretare gjyqesore Alsma Rama, sot me date 30.10.2015, ora 15.30, mori ne shqyrtim materialin procedues me:

KERKUES : Prokuroria prane Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane , e perfaqesuar nga prokurori Julian Zonja.

OBJEKTI: Sekuestrimin e shumave ne llogari bankare prane BKT, dega “Ismail Qemali”, nr. 30 Tirane, ne kuader te veprimeve hetimore qe kryhen per procedimin penal, nr., dt 24.10.2015, per vepren penale te “Vjedhja”, parashikuar nga neni 134/1 i Kodit Penal, ne ngarkim te shtetasit K. G..

BAZA LIGJORE: Neni 208 dhe 210 i Kodit te Procedures Penale

Gjykata, pasi degjoi kerkimin perfundimtar te prokurorit, i cili kerkoi pranimin e kerkeses, shqyrtoi materialin procedues qe shoqeron kerkesen:

V E R E N

Prokuroria prane Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane ne daten 30.10.2015, ka paraqitur ne Gjykate nje kerkese per; *Sekuestrimin e shumave ne llogari bankare prane BKT, dega “Ismail Qemali”, nr. 30 Tirane, ne kuader te veprimeve hetimore qe kryhen per procedimin penal, nr., dt 24.10.2015, per vepren penale te “Vjedhja”, parashikuar nga neni 134/1 i Kodit Penal, ne ngarkim te shtetasit K. G., bazuar kjo kerkese ne nenin 208 dhe 210 te Kodit te Procedures Penale.*

Duke i’u referuar gjendjes ne fakt te ceshtjes per gjykim, Gjykata veren se ; Prokuroria Tirane ka filluar procedimin nr. penal date 24.10.2015 per vepren penale te “Vjedhje”, parashikuar nga nenet 134/1 i Kodit Penal , ne ngarkim te shtetasit K. G., mbi bazen e kallezimit te shtetases E. X..

Nga aktet qe shoqerojne kerkesen referojne ne dyshimin se ; *ne daten 23.10.2015 ne Komisariatin e Policise Nr. 2 Tirane beri kallezim shtetasja E. X., me banim ne rrugen “N.....”, pallati “R.....”. Kjo shtetase eshte 19 vjec dhe jeton e vetme ne shtepi, pasi familja e saj jeton ne Greqi, nderkohe qe vazhdon vitin e fundit te shkolles ne shkollen e mesme “P.....”. Pas muajit Gusht qe shtetasja E. X. ka ardhur nga Greqia ka zene shume shoke te rinj nga shoqja e saj A. K. dhe keta shoke I futur edhe here pas here ne shtepi. Disa prej shokeve te saj kane kaluar edhe naten ne shtepine e saj per shkak se kane patur shtepine larg dhe keta shoke kane qene I. D., F. H. dhe K. G.. Kallezuesja kur ka ardhur nga Greqia ka marre me vete nje shume parash prej 13.500 euro nga mamaja e saj dhe nje shume tjeter*

parash per shpenzime vetjake. Keto shuma lekesh I kishte fshehur ne disa corape, brenda nje pale kepucesh tek dollapi I saj ne dhomen e gjumit. Gjate kesaj periudhe ajo ka marre per nevoja te saj leke, vetem nga pjesa qe I takonte asaj. Ne daten 19.10.2015 ajo ka shkuar per te marre disa leke tek dollapi, dhe ka vene re se kepucesh ishin te levizura dhe pasi ka kontrolluar leket qe ndodheshin tek shuma 13.500 euro, ka konstatuar se aty mungote nje shume prej 5000 euro. Per kete ajo ka dyshuar se dikush nga grupi I saj I shoqerise mund tia kishte marre keto leke dhe ka mbledhur shoqerine e saj duke ja thene kete problem. Ne bisede e siper disa prej tyre jane shprehur se duhet te shkonin ne polici per te kallezuar dhe E. e ka bere kete gje. Ajo ka dyshuar tek dy persona F.H. dhe K. G., pasi ata ishin te vetmit qe kishin fjetur te fundit ne banesen e saj, ne daten 14.10.2015 duke u gdhire data 15.10.2015. Ne kete date E. ka ikur ne shkolle ne mengjes, ndersa F. ka dale nga shtepia ne oren 10.30 dhe I fundit kishte dale K. ne oren 12.00. Nga pyetja e te gjithë ketyre shtetasve, rezultoi se ishte shtetasi K. G. qe kishte marre leket ne banesen e shtetasës E. X., gje te cilen e pranoi edhe vete ky shtetas. Ate dite ai ishte ngritur vone nga gjumi dhe ishte bere kurioz per te pare dhomen e kallezueses. Pasi eshte futur ne dhomen e E. ka shkuar tek dollapi dhe aty ne raftin e fundit ka pare nje shporte, ku brenda ne shporte ishte nje cante dhe nje pale kepuce me corape. Keto corape ishin te fryra dhe brenda tyre ka pare se kishte leke, nga te cilat ka marre nje pjese. Me pas ka dale nga shtepia dhe ka takuar E., te ciles I ka dhene celesin e shtepise. Ne ditet ne vazhdim, shtetasi K. G. me leket e marra ne daten 16.10.2015 ka blere dy telefona Iphone 6 tek dyqani Atom Computer tek sheshi Uillson ne vleren prej 1200 euro, ka shpenzuar shume nga leket per te blere veshje tek TEGU per vete dhe per shoqen e tij V. D. dhe ne daten 21.10.2015 ka depozituar nje shume prej 2450 euro tek banka BKT ne zonen e bllokut. Per shpnezimet qe ka bere shtetasi K. G. per veshje deklaroi te njejta fakte edhe shtetasja V. D., e cila kishte marre si dhurate nje prej telefonave Iphone nga K., duke mos I ditur se I kishte blere me leke te vjedhura, pasi K. I kishte thene se leket ia kishte sjelle halla e tij nga Anglia per ditelindje ne fillim te muajit Tetor. Po keshtu edhe shtetaset A. K. dhe F. H. kane konfirmuar se kishin pare K. qe nga data 15.10.2015 kishte blere telefon te ri Iphone si dhe veshje te reja. Pasi eshte bere dhe kontrolli I baneses se ketij shtetasi, I cili jetonte me qera ne rrugen “J.....” dhe ne dhomen e tij te gjumit jane gjetur mandatet e depozites tek banka BKT, fatura e blerjes se dy telefonave Iphone 6 dhe shuma 150 euro ne prerje 50 euro.

Sipas mandatit te depozitimit te BKT dt 21.10.2015, ora 13.36, eshte bere depozitimi ne cash ne valute i shumes 2450 euro ne llogarine nr.155 i klientit K. V. G., dhe se ky depozitim eshte bere nga shtetasja V. D..

Sa me siper, duke qene se kjo shume e depozituar eshte pjese e parave qe shtetasi K. G., dyshohet se i ka vjedhur shtetasës E. X., sekuestrimi i tyre, sipas kerkeses se prokurorise, eshte i domosdoshem per vertetimin e fakteve, dhe se ekzistojne kushtet e nenit 208 dhe 210 te k.pr.penale per te bere kete veprim hetimor.

Ky sekuestrim, sipas kerkeses se prokurorit, duhet te behet nga BKT , dega “Ismail Qemali”, nr. 30, Tirane dhe oficeri i policose gjyqesore, Enis Shehu.

Nisur nga sa me siper **Gjykata** cmon se duhet pranuar kerkesa e prokurorit per; *Sekuestrimin e shumave ne llogari bankare prane BKT, dega “Ismail Qemali”, nr. 30 Tirane, ne kuader te veprimeve hetimore qe kryhen per procedimin penal, nr., dt 24.10.2015, per vepren*

penale te “Vjedhja”, parashikuar nga neni 134/1 i Kodit Penal, ne ngarkim te shtetasit K. G., pasi ekzistojne te gjitha kriteret ligjore te parashikuara ne nenin 208 dhe 210 te K.Pr.Penale dhe se ky sekuestrim eshte nje veprim i domosdoshem per kete hetim.

PER KETO ARSYE

Gjykata bazuar ne nenet 208 dhe 210 te Kodit te Procedures Penale

V E N D O S I

- A)** Pranimin e kerkeses.
- B)** Sekuestrimin e shumes 2450 (dymije e katerqind e pesedhete) euro, te depozituara ne llogarine me nr.155 i klientit K. V. G., ose V. D., ne Banken Kombetare Tregtare , Dega “Ismail Qemali”, nr. 30, Tirane.
- C)** Me sekuestrimin te ngarkohen oficeri i policise gjyqesore Enis Shehu dhe Banka Kombetare Tregtare , Dega “Ismail Qemali”, nr. 30, Tirane.
- D)** Kunder ketij vendimi lejohet ankim sipas ligjit ne Gjykatën e Apelit Tirane.

Tirane , me 30.10.2015

GJYQTARE

Brunilda KADI

Sekretare

Alsma RAMA